



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më 08.01.2021 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.
Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Informatë nga Drejtorja e Shërbimeve Publike;
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019;
4. Informatë nga Drejtorja e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në Komunën e Prishtinës;
5. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01-464/01-263767/18, dt. 01.11.2018, për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
6. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë;
7. Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021;
8. Propozimvendimi për formimin e komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021;
9. Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Termokos", SHA Prishtinë;
10. Propozimrregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona";

11. Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se një vit;
12. Propozimvendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01-0239805/20, më 31.12.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

